



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



**ZL.Anr.362/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Diellëza Feta nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), në Obiliq, për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.362/2017 e datës 23.10.2017 e Diellëza Feta nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Diellëza Feta nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Obiliq, me të cilën pretendon se ka dyshime se në Qendrën e Votimit (QV), 1501/1R deri në 1501/9D, në shkollën fillore “Ibrahim Rugova” në Obiliq iu janë bartë votat tek kandidatët tjerë i po të njëjtit subjekt politik.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljes e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 362/2017 me datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli  
Faton Ademi**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-***